Flet për "Epokën e re", gjenerallejtënant Kadri Kastrati

# Na lavdëruan për para

## - Parakaluam sipas misionit si forcë profesionale
## - Për kapacitetet e FSK-së pritet deklaratë pozitive nga NATO-ja



Kreu i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, ka marrë vlerësime të larta nga ekspertët ushtarakë për paradën e 17 shkurtit. Në këtë intervistë për "Epokën e re", ai ka thënë se kjo paradë është një sukses i të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Duke iu përgjigjur kritikëve të kësaj parade, ai ka thënë se FSK-ja ka performuar në bazë të misionit që ka si një forcë profesionale dhe lehtë e armatosur

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 SHKURT - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, e ka vlerësuar lart paradën ushtarake të 17 shkurtit, të cilën kjo forcë e realizoi për herë të parë për nder të pesëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Në këtë intervistë për "Epokën e re", ai ka thënë se kuadratet e FSK-së me këtë rast kanë bërë një performancë të shkëlqyeshme. Sipas tij, ky është edhe një sukses i radhës i kësaj force. "Për neve kjo paradë është edhe një sukses më shumë. Ky është një sukses i të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Për këtë edhe shumë ekspertë të këtij lëmi kanë shprehur vlerësime të larta", ka thënë Kastrati.

Madje, ai ka deklaruar se vlerësime të larta për këtë paradë FSK-ja ka marrë edhe nga miqtë ndërkombëtarë, të cilët kanë ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të kësaj force.

Gjeneral Kastrati ka folur edhe për kritikat që FSK-ja ka marrë rreth kësaj parade, duke thënë se kjo forcë ka performuar në bazë të misionit që ka FSK-ja si një forcë profesionale dhe lehtë e armatosur. "FSK-ja për herë të parë në këtë përvjetor ka parakaluar me armatimin e lehtë të krahut si dhe me një numër të automjeteve të saj, duke llogaritur edhe dy autoblindat e tipit Kobra, që është donacion i Qeverisë së Turqisë. Ne veprojmë në bazë të misionit që FSK-ja e ka si një forcë profesionale dhe lehtë e armatosur", është shprehur ai. E sa i përket armatimit të kësaj force, ai ka thënë se FSK-ja është e pajisur me armatime të krahut, armë të standardit të NATO-s, të tipit Hekler & CO dhe COLT-it. FSK-ja do të armatoset në bazë të planit të zhvillimit dhe armatosjes me të gjitha ato armë që janë të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Ligji për FSK-në, për misionin aktual që ka.

**"Epoka e re":** *Z. Gjeneral, ceremonia kryesore e pesëvjetorit të pavarësisë ka qenë parada ushtarake e FSK-së. Si e vlerësoni këtë paradë?*

**Gjeneral Kastrati:** Po, ceremonia me rastin e shënimit të pesëvjetorit të pavarësisë së Kosovës është shënuar për herë të parë nëpërmjet një parade, mbajtur në sheshin "Nëna Tereze" dhe "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Parakalimin e kanë përcjellë personalitetet më të larta shtetërore dhe qytetarët e Kosovës, të cilët kanë shprehur simpati për nivelin e paradës dhe për arritjet profesionale të FSK-së. Të gjitha kuadratet e FSK-së kanë qenë në nivelin më të lartë të mundshëm. Unë si komandant i FSK-së për këtë i përgëzoj dhe mund të them se jemi, çdo ditë e më shumë, duke e rritur cilësinë nëpërmjet profesionalizimit të FSK-së, që edhe është synimi ynë.

**"Epoka e re":** *Çfarë do të thotë për FSK-në dhe për ju kjo paradë?*

**Gjeneral Kastrati:** Performanca e shkëlqyeshme e kuadrateve të FSK-së më 17 shkurt, duke filluar nga togu ceremonial, batalioni i parë, i dytë dhe i tretë i BRSH-së, Brigada për Mbështetje Operacionale, Rexhimenti i Mbrojtjes Civile dhe Qendrës për Studime Universitare. Për ne kjo paradë është edhe një sukses më shumë. Ky është një sukses i të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së. Për këtë edhe shumë ekspertë të këtij lëmi kanë shprehur vlerësime të larta.

**"Epoka e re":** *Nga disa persona publikë është kritikuar kjo paradë për mungesë të disa pajisjeve ushtarake, si u përgjigjeni këtyre kritikave?*

**Gjeneral Kastrati:** FSK-ja për herë të parë në këtë përvjetor ka parakaluar me armatimin e lehtë të krahut si dhe me një numër të automjeteve të saj, duke llogaritur edhe dy autoblindat e tipit Kobra, që është donacion i Qeverisë së Turqisë. Ne veprojmë në bazë të misionit që FSK-ja e ka si një forcë profesionale dhe lehtë e armatosur.

**"Epoka e re":** *Kritikat ndërlidheshin rreth armatimit dhe mungesës së mjeteve ushtarake, kur pritet që kjo forcë të pajiset me mjete të tjera ushtarake?*

**Gjeneral Kastrati:** FSK-ja është e pajisur me armatim të krahut, armë të standardit të NATO-s, të tipit Hekler & CO dhe COLT-it. FSK-ja do të armatoset në bazë të planit të zhvillimit dhe armatosjes me të gjitha ato armë që janë të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Ligji për FSK-në, për misionin aktual që ka.

**"Epoka e re":** *Po nga ndërkombëtarët, miqtë të cilët kanë ndihmuar në ngritjen e kësaj force, keni marrë ndonjë vlerësim për këtë paradë. Nëse po, cilat kanë qenë ato vlerësime?*

**Gjeneral Kastrati:** Të gjithë miqtë tanë, të cilët e kanë ndihmuar dhe po e ndihmojnë FSK-në, e të cilët kanë marrë pjesë në paradë, kanë shprehur vlerësime të larta për paradën dhe FSK-në. Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajori Timothy Orr, ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, Arben Imami, min-

## FSK-ja vazhdon bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Ajovës

Prishtinë, 20 shkurt - Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës të mërkurën për një vizitë pune ka qëndruar një delegacion i lartë i Gardës Kombëtare të Ajovës, i prirë nga komandanti i saj, gjeneralmajor Timothy Orr. Me këtë rast, zëvendësministri Shemsi Veseli e ka falënderuar gjeneralin Orr për të gjitha angazhimet që po bën SHBA-ja nëpërmjet bashkëpunimit intensiv për Kosovën dhe FSK-në, si dhe e ka njoftuar për zhvillimet e fundit të FSK-së. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneralbrigade Zymer Halimi, nëpërmjet një informimi prezantoi para të pranishmëve, punën e bërë deri më tani të FSK-së, në shkollimin, trajnimet dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Gjeneral Halimi të pranishmit i njoftoi edhe për dokumentacionet që kanë të bëjnë me çështjen e dërgimit të trupave jashtë vendit dhe gatishmërinë operacionale. Komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneralmajori Timothy Orr, ka shprehur admirimin e veçantë për arritjet profesionale dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin e dyanshëm në shumë fusha të përbashkëta, me theks të veçantë në fushën e trajnimeve, ushtrimeve me ekipe mobile trajnime në fushën e komunikimit dhe shkollimit.

# dën



istri i Mbrojtjes së Maqedonisë, Fatmir Besimi, shefi i Shtabit të Ushtrisë së Shqipërisë, Xhemal Gjunkshi, etj.

**"Epoka e re":** *Gjeneral, ende nuk ka ndodhur miratimi i kapaciteteve të pota të FSK-së nga Këshilli i NATO-s, kur pritet të ndodhë një gjë e tillë?*

**Gjeneral Kastrati:** Me rëndësi është se ne i kemi arritur kapacitetet e plota operacionale. Këtë e ka konfirmuar edhe komandanti i KFOR-it. Unë jam shumë optimist se gjatë këtij viti do të kemi një deklaratë nga NATO-ja, sepse problemi ka qenë te disa shtete që ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe janë anëtare të NATO-s. Kjo barrierë do të tejkalohet dhe FSK-ja do të ecë drejt arritjes së objektivave të veta.



# (foto)lajm

**Bashkëpunim i ngushtë në mes FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës** Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, sot, për një vizitë pune ka qëndruar një delegacion i lartë i Gardës Kombëtare të Ajovës, të prirë nga komandanti i saj, gjeneralmajor Timothy Orr. Delegacioni u prit nga zëvendësministri Shemsi Veseli ku morrën pjesë edhe Bejtush Gashi, zëvendësministër, komandanti i FSK-së, gjeneral lejtnant Kadri Kastrati, zëvendës komandanti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneral brigade Zymer Halimi, major Hoxha, etj. Me këtë rast, zëvendësministri Shemsi Veseli e ka falënderuar gjeneralin Orr, për të gjitha angazhimet që po bënë SHBA-ja përmes bashkëpunimit intensiv për Kosovën dhe FSK-në, si dhe e ka njoftuar për zhvillimet e fundit të FSK-së. Komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneralmajori Timothy Orr, ka shprehur admirimin e veçantë për arritjet profesionale dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin e dyanshëm në shumë fusha të përbashkëta, me theks të veçantë, në fushën e trajnimeve, ushtrimeve me ekipe mobile trajnime në fushën e komunikimit dhe shkollimit.

BOTA SOT

## Data për Serbinë varet nga dialogu me Kosovën

Shefi i diplomacisë gjermane, Guido Westerwelle ka deklaruar se Gjermania e mbështet Serbinë në rrugën e saj kah Bashkimi Evropian, por, që vendimi për datën e negociatave varet nga rezultatet konkrete të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës dhe se bisedimet e kësaj jave janë të një rëndësie të madhe për këtë proces.

"Gjermania nuk do të paraqesë kërkesa të reja, por, as nuk do të heqë dorë nga kriteret e vendosura", ka thënë Westerwelle në konferencën për gazetarë pas takimit me zëvendëskryeministrin e Serbisë, Aleksandër Vucic.Raundi i sotëm i bisedimeve në Bruksel ka përfunduar pa rezultate, derisa kryeministri kosovar Hashim Thaçi dhe ai serb Ivica Dacic do të takohen sërish më 4 mars. ■

# Komuna e Prizrenit, e zhytur në borxhe

**"Në pasqyrën e faturave (obligimeve) të papaguara, në total arrihet shifra prej 933 mijë eurosh. Vlera më e madhe e faturave të papaguara është në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me 450 mijë euro", thuhet në raportin e "EC ma Ndryshe"**

**Tribuna**
gazeta@gazetatribuna.com



Kryetari i Komunës së Prizrenit Ramadan Muja dhe kryetari i PDK-së Hashim Thaçi

**Prizren, 20 shkurt** – Komuna e Prizrenit është zhytur në borxhe të mëdha, ka konstatuar një raport i organizatës "Emancipimi Civil më Ndryshe". "EC Ma Ndryshe" gjatë muajit shkurt ka shqyrtuar pasqyrat financiare të komunës për periudhën janar-dhjetor 2012.

Në bazë të raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2012, organizata ka hasur në disa të dhëna që paraqesin shqetësime serioze sa i përket mënyrës së menaxhimit të parasë publike nga qeverisja komunale. Analiza e thjeshtë e këtij raporti tregon se komuna e Prizrenit vazhdon që të operojë me shuma të mëdha të faturave të papaguara.

"Në pasqyrën e faturave (obligimeve) të papaguara, në total arrihet shifra prej 933 mijë eurosh. Vlera më e madhe e faturave të papaguara është në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me 450 mijë euro, pastaj vijnë: pagat me 180 mijë euro, shërbimet komunale me 123 mijë euro, investimet kapitale me 101 mijë euro dhe subvencionet me 79 mijë euro", thuhet në raportin e kësaj organizate.

Sipas raportit, detyrimet e komunës së Prizrenit mund të jenë edhe më të mëdha. Detyrimet kontingjente që mund të prekin buxhetin komunal kapin vlerën prej 1 milion e 743 mijë eurove, e që përfshijnë kompensime të ndryshme, pagesën e të ardhurave personale, borxheve e pretendimeve tjera.

Shuma e detyrimeve të komunës së Prizrenit është e madhe, ndërkohë që ka pasur rënie të dukshme të investimeve kapitale. Derisa në vitin 2011 janë shpenzuar 14 milionë e 494 mijë euro për investime kapitale, në vitin 2012 janë shpenzuar 12 milionë e 182 mijë euro ose 2.3 milionë euro më pak investime kapitale.

"EC Ma Ndryshe" shpreh shqetësimin edhe në lidhje me rënien në inkasimin e të hyrave vetanake. Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2012 ka planifikuar që të inkasojë 5 milionë e 491 mijë euro, por ka inkasuar vetëm shumën prej 4 milionë e 330 mijë eurove, përderisa në vitin 2011 pati inkasuar 4 milionë e 999 mijë euro.

Pavarësisht kësaj performance jo të kënaqshme buxhetore, komuna e Prizrenit ka paguar më shumë për shpenzimet e udhëtimit, pasi që në vitin 2012 janë shpenzuar 96 mijë euro në krahasim me vitin 2011 kur janë shpenzuar 74 mijë euro, pastaj për shërbimet e telekomunikimit ka paguar 95 mijë euro në krahasim me vitin 2011 kur ka paguar 42 mijë euro, për shërbime 312 mijë euro në krahasim me 298 mijë eurot e vitit 2011, derisa për reprezentacion janë harxhuar 88 mijë euro, apo 3 mijë euro më pak se në vitin 2011.

"EC Ma Ndryshe" përkujton se Raporti i fundit i Auditorit të Përgjithshëm për komunën e Prizrenit kishte konstatuar se pushteti lokal nuk ka arritur që të qeverisë mirë me paranë publike, derisa RVF-ja e vitit 2012 nuk jep dëshmi të forta për përmirësimin e menaxhimit financiar.

Sipas kësaj organizate, në marrjen e vendimeve buxhetore, kryetari i Komunës duhet t'i ketë parasysh standardet e qeverisjes së mirë, të menaxhimit adekuat me paranë publike si dhe nivelin socio-ekonomik të qytetarëve në përgjithësi.

"EC Ma Ndryshe" rekomandon edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës që të ushtrojnë në mënyrë më efikase rolin e mbikëqyrësit të ekzekutivit, sidomos kur bëhet fjalë për buxhetin komunal dhe mënyrën e realizimit të tij.

*Shuma e detyrimeve të komunës së Prizrenit është e madhe, ndërkohë që ka pasur rënie të dukshme të investimeve kapitale. Derisa në vitin 2011 janë shpenzuar 14 milionë e 494 mijë euro për investime kapitale, në vitin 2012 janë shpenzuar 12 milionë e 182 mijë euro ose 2.3 milionë euro më pak investime kapitale*

## Bashkëpunim ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për një vizitë pune ka qëndruar një delegacion i lartë i Gardës Kombëtare të Ajovës, të prirë nga komandanti, gjeneralmajor Timothy Orr.

Delegacioni u prit nga zv/ministri Shemsi Veseli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati etj.

Me këtë rast, zv/ministri Shemsi Veseli e ka falënderuar gjeneralin Orr për të gjitha angazhimet që po bën SHBA-ja nëpërmjet bashkëpunimit intensiv me Kosovën dhe FSK-në, si dhe e ka njoftuar për zhvillimet e fundit të FSK-së.

Ndërsa, drejtori i Drejtorisë për Operacione gjeneral brigade, Zymer Halimi, prezantoi punën e FSK-së në shkollimin, trajnimet dhe ngritjen profesionale të FSK-së.

Gjeneral Halimi të pranishmit i njoftoi edhe për dokumentacionet që kanë të bëjnë me çështjen e dërgimit të trupave jashtë vendit dhe gatishmërinë operacionale.

Komandanti i Gardës Kombëtare, gjeneralmajori Timothy Orr, ka shprehur admirimin e veçantë për arritjet profesionale të FSK-së.

Ai ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin e dyanshëm në shumë fusha të përbashkëta, me theks të veçantë, në fushën e trajnimeve, ushtrimeve me ekipe mobile, trajnime në fushën e komunikimit dhe shkollim.





# Tri raste të reja me H1N1

Arrin në pesë numri i të prekurve me virusin H1N1 në Gjilan. Dy raste të diagnostikuara më herët dhe tri raste që janë verifikuar pozitiv të mërkurën me H1N1 e çojnë në pesë numrin e të prekurve me këtë virus.

Selvete Shurdhani, zv/drejtoreshë e spitalit të Gjilanit, tha se rastet janë të konfirmuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Prishtinë. Ajo tha se rastet me H1N1 po trajtohen me terapinë adekuate dhe janë të ndara në repartin e infektives, dhe se ka medikamente të mjaftueshme për ta përballuar këtë fluks.

